

Kush duhet të marrë MCAS?

Të gjithë studentëve të klasave 3-8 dhe 10 të cilët ndjekin programet shkollore të financuara publikisht u kërkohet të marrin pjesë në vlerësimet MCAS për gjithë shtetin. Një numër relativisht i vogël i studentëve të cilët kanë aftësi të kufizuara më të rënda e bëjnë MCAS-Alt nëse nuk janë në gjendje të kryejnë testet MCAS të zakonshme, edhe me akomodime.

Kualifikimi për të marrë pjesë në një vlerësim alternativ bëhet çdo vit në bazë të kritereve të DESE nga skuadra IEP e studentit, e cila përfshin prindërit/kujdestarët. Studentët që kryejnë vlerësimin alternativ marrim mësim të individualizuara të cilat janë modifikuar në masë të konsiderueshme krahasuar me mësimet që marrin studentët e tjerë. Ju lutemi të mbani parasysh se pjesëmarrja në MCAS-Alt mund të ndikojë tek aftësia e fëmijës suaj për të marrë diplomën e shkollës së mesme.

Pse studentët me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në MCAS dhe MCAS-Alt.

Kështu është ligji.

Ligji shtetëror dhe federal kërkon pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në vlerësimet shtetërore. Vlerësimi alternativ u jep mundësi studentëve që kanë më shumë aftësi të kufizuara konjitive, të cilët nuk mund të kryejnë testet MCAS të zakonshme që "të tregojnë çfarë dinë" dhe të marrin mësim në një nivel që është sfidues por i arritshëm për ta.

MCAS ndihmon për të përcaktuar se sa mëson një student.

Një MCAS-Alt tregon se cilat aftësi ka mësuar studentit gjatë vitit shkollor. Rezultatet e arritjeve japin informacion që mund të përdoret për të dalluar synimet dhe mësimet sfiduese për të ardhmen.

Përfshirja e të gjithë studentëve siguron që të gjithë studentëve t'u jepet mësim.

Llogaritja e rezultateve të studentëve që kryejnë MCAS-Alt do të thotë që ata studentë ka më tepër gjasa të merren në konsideratë kur merren vendime për burimet.

Ndërsa të mësuarit përmirësohet, pritshmëritë rriten.

Provat tregojnë se studentët mësojnë më shumë kur përfshihen në mësim në bazë të standardeve mësimore të shtetit dhe kur marrin pjesë në vlerësime duke u bazuar në ato standarde mësimore.

Si përdoren rezultatet MCAS-Alt?

Rezultatet MCAS-Alt duhet të përdoren nga shkolla dhe nga skuadra IEP:

- për të dalluar synimet akademike sfiduese dhe për të planifikuar mësimin për studentin
- për të vlerësuar përparimin që ka bërë studentin për të fituar aftësitë në bazë të standardeve akademike alternative nga kuadrot e planeve mësimore të Masaçusetsit
- për të caktuar burime të mjaftueshme shkollore për shkollimin e studentëve
- për të përcaktuar nëse shkollat dhe qarqet po bëjnë përparim ndërsa shkollojnë studentët që kanë aftësi të kufizuara më të rënda

A mund t'i plotësojnë studentët kërkesat e shtetit për diplomimin dhe të diplomohen nëse marrin pjesë MCAS-Alt?

Ne duam që të dini se pjesëmarrja në një vlerësim alternativ mund të ndikojë te mundësia që fëmija juaj plotësojë kërkesat e shtetit për të marrë një diplomë të shkollës së mesme sepse në MCAS-Alt vlerësohen standardet mësimore që janë **nën** pritshmëritë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e shtetit për diplomimin. Prandaj, studentët që marrin pjesë në MCAS-Alt nuk do të jenë në gjendje të plotësojnë kërkesat e shtetit për diplomimin.

Qëllimi i kërkesës së shtetit për diplomimin është të sigurohemi që një student që merr një diplomë të Masaçusetsit të shfaqë aftësi bazë nëartet e gjuhës angleze, matematikë, shkencë dhe teknologji/inxhinieri para se të hyjë në shkollimin post-sekondar ose në tregun e punës. Kërkesa është vendosur për të gjithë studentët, duke filluar me klasën e diplomimit të vitit 2003. Mund të mësoni më shumë lidhur me kërkesat për diplomimin në www.doe.mass.edu/mcas/graduation.html.

Për të plotësuar kërkesat e shtetit për diplomimin, një student duhet të bëjë të mëposhtmet:

- të kryejë dhe të kalojë testet MCAS të nevojshme;
- të shfaqë zotësi që tregojnë njohuritë dhe aftësitë e studentit në nivelin e arritjeve të klasës 10; ose
- t'i jepet një Apel Performance MCAS në të cilin dokumentohet mesatarja e pikëve krahasuar me studentët e tjerë që kryejnë mësimet në nivelin të klasës. Informacion lidhur me apelimet MCAS gjendet në <https://www.doe.mass.edu/mcasappeals/>.

Për më shumë informacion

Sistemi i Masaçusetsit për Vlerësimin Gjithëpërfshirës (Massachusetts Comprehensive Assessment System, MCAS) www.doe.mass.edu/mcas

Vlerësimi alternativ MCAS (MCAS Alternate Assessment, MCAS-Alt) www.doe.mass.edu/mcas/alt

Kërkesat e pjesëmarrjes në MCAS për studentët me aftësi të kufizuara www.doe.mass.edu/mcas/accessibility

Kërkesat e diplomimit dhe apelimet e performancës MCAS..... www.doe.mass.edu/mcas/graduation.html

Nëse keni pyetje, dërgoni..... email në: mcas@mass.gov

Pranverë 2024 Vlerësimi Alternativ i MCAS (MCAS-Alt) Raport i Prindërve/Kujdestarëve



Emri:

SASID:

Shkollë:

Klasë:

Distrikti:

Datëlindja:

Bashkëngjitur janë rezultatet e fëmijës suaj nga Vlerësimi Alternativ MCAS (MCAS-Alt) i vitit 2024. Të gjithë studentëve u kërkohet të marrin pjesë në MCAS, qoftë duke kryer testet MCAS standarde qoftë duke marrë pjesë në Vlerësimin Alternativ MCAS (MCAS-Alt) për studentët që kanë aftësi të kufizuara më të rënda të cilët plotësojnë kërkesat për kualifikimin. Shkolla e fëmijës suaj ka paraqitur MCAS-Alt në pranverën e kaluar, siç tregohet në planin e saj IEP ose 504. MCAS-Alt është një regjistrim i nivelit të arritjeve të fëmijës suaj, duke përfshirë një koleksion të punës akademike të tij ose të saj. Para se të paraqitej, shkollës së fëmijës suaj i është kërkuar që t'ju ftojë të shqyrtoni vlerësimin e fëmijës suaj.

Ju lutemi të takoheni me mësuesin(t) e fëmijës suaj për të diskutuar se çfarë do të thonë këto rezultate dhe të flisni lidhur me synimet e fëmijës suaj për vitin e ardhshëm shkollor. Mbështetja juaj është jashtëzakonisht e rëndësishme. Departamenti i Arsimit Fillor dhe Sekondar (DESE) dëshiron të falënderojë mësuesit për punën e tyre të palodhur gjatë përpilimit të MCAS-Alt dhe për kontributin e tyre në këtë punë të rëndësishme dhe të çmuar.

Rezultatet e përgjithshme të fëmijës suaj		
Artet e gjuhës angleze	Matematikë	Shkencë dhe Teknologji/Inxhinieri
Niveli i arritjeve	Niveli i arritjeve	Niveli i arritjeve

Qëllimet e MCAS-Alt

MCAS-Alt është një vlerësim i krijuar për të matur arritjet e studentëve që kanë aftësi të kufizuara konjitive më të rënda në fushat e arteve të gjuhës angleze, matematikë, shkencë dhe teknologji/inxhinieri. Pritet që fëmija juaj të shfaqë njohuritë e standardeve mësimore të shtetit në një nivel që është sfidues dhe i përshtatshëm.

Qëllimi i MCAS-Alt është për t'u siguruar që shkollat po u mësojnë standardet të gjithë studentëve, pavarësisht aftësive të tyre të kufizuara dhe edhe pse nuk mund të shfaqin atë çka dinë në një test standard.

Çfarë është MCAS-Alt?

MCAS-Alt i fëmijës suaj përfshin mostra të punës së tyre në shkollë dhe një regjistrim të përparimit të tyre në lëndën ose lëndët që po vlerësohen. Secili vlerësim përfshin mostra pune dhe dokumentacion të përparimit në të njëjtat lëndë që po vlerësohen në testet MCAS standarde për një student në atë klasë. Studentët që kryejnë MCAS-Alt punojnë lidhur me njohuritë dhe aftësitë duke u bazuar në standardet alternative të arritjeve. Elementë të mëtejshëm lidhur me MCAS-Alt gjenden te *manuali i mësuesve për MCAS-Alt*, i cili gjendet në <http://www.doe.mass.edu/mcas/alt/edmanual.docx>.

Emri:
SASID:

Klasa:
Pranverë 2024

Përshkrues të nivelit të arritjeve

Kalon Pritshmëritë	Një student që ka performuar në këtë nivel ka tejkaluar pritshmëritë e nivelit të klasës duke përvetësuar lëndën.
Arrin Pritshmëritë	Një student që ka performuar në këtë nivel ka arritur pritshmëritë e nivelit të klasës dhe në këndvështrimin akademik është në rrugën e duhur për të pasur sukses në klasën aktuale në këtë lëndë.
Arrin Pjesërisht Pritshmëritë	Një student që ka performuar në këtë nivel ka arritur pjesërisht pritshmëritë e nivelit të klasës në këtë lëndë. Shkolla, në konsultim me prindin/kujdestarin e studentit duhet të shqyrtojë nëse studenti ka nevojë për ndihmë akademike për të pasur sukses në lëndë.
Nuk Arrin Pritshmëritë	Një student që ka performuar në këtë nivel nuk ka arritur pritshmëritë e nivelit të klasës në këtë lëndë. Shkolla, në konsultim me prindin/kujdestarin e studentit, duhet të përcaktojë ndihmën akademike të koordinuar dhe/ose mësimin shtesë që i nevojitet studentit për të pasur sukses në këtë lëndë.
Bën përparim	Një student në këtë nivel ka shfaqur kuptueshmëri të pjesshme nën pritshmëritë e nivelit të klasës për sa u përket standardeve dhe njohurive bazë që gjenden në kuadrin e planit mësimor të Masaçusetsit për lëndën. Studentët në këtë nivel mësojnë vazhdimisht njohuri, aftësi dhe koncepte të reja. Studentët kanë nevojë për drejtim dhe ndihmë minimale dhe, performanca e tyre është në thelb e saktë.
Në zhvillim	Në këtë nivel studentit ka shfaqur kuptueshmëri të thjeshtë nën pritshmëritë e nivelit të klasës për sa u përket një numri të kufizuar standardesh dhe njohurive bazë në kuadrin e planit mësimor të Masaçusetsit për lëndën. Studentët në këtë nivel kanë nevojë për drejtim dhe ndihmë, dhe performanca e tyre është e kufizuar dhe jo e qëndrueshme.
Ndërgjegjësimit	Një student në këtë nivel ka shfaqur shumë pak kuptueshmëri për sa u përket standardeve dhe njohurive bazë që gjenden në kuadrin e planit mësimor të Masaçusetsit për lëndën. Studentët në këtë nivel kanë nevojë për shumë drejtim dhe ndihmë, dhe performanca e tyre është më së shumti e pasaktë.
E paplotë	Në vlerësim nuk janë dhënë prova dhe informacione të mjaftueshme për të bërë të mundur që të përcaktohet një nivel i arritjeve për lëndën.

Pjesa më sipër tregon nivelin e përgjithshëm të arritjeve të fëmijës suaj në secilën fushë të vlerësimit alternativ.

Fusha MCAS-Alt është vlerësuar në secilën fushë që tregohet më poshtë. Rezultatet për *nivelin e kompleksitetit, shfaqjen e aftësive dhe koncepteve (saktësi)*, dhe pavarësia janë kombinuar për të dhënë nivelin e përgjithshëm të arritjeve.

Fushat e vlerësimit MCAS-Alt dhe rezultatet e fëmijës suaj

	ARTET E GJUHËS ANGLEZE												
	Niveli i kompleksitetit	Shfaqja e aftësive dhe koncepteve				Pavarësi	Vetë vlerësim	Performancë e përgjithshme					
	1	2	3	4	5	M 1	2	3	4	M 1	2	1	2
Gjuha	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□
Lexim	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□
Shkrim	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□	□

	MATEMATIKË							
	Niveli i kompleksitetit	Shfaqja e aftësive dhe koncepteve				Pavarësi	Vetë vlerësim	Performancë e përgjithshme
ÇELËS për tekstin që mund të shihni në kutitë sipër raportit të fëmijës suaj:								
Expressions and Equations [Shprehjet dhe ekuacionet]	Number and Operations in Base Ten [Numri dhe veprimet në dhjetëshe]			Ratios and Proportional Relationships [Raportet dhe lidhjet përpjestimore]				
Functions [Funksionet]	Number and Operations – Fractions [Numri dhe veprimet – Thyesat]			Statistics and Probability [Statistikat dhe probabiliteti]				
Measurement and Data [Matjet dhe të dhënat]	Geometry [Gjeometri]			The Number System [Sistemi i numrave]				
Operations and Algebraic Thinking [Veprimet dhe të menduarit algjebrik]	Algebra [Algjebër]			Number and Quantity [Numri dhe sasia]				

	SHKENCË dhe TEKNOLOGJI/INXHINIERI							
	Niveli i kompleksitetit	Shfaqja e aftësive dhe koncepteve				Pavarësi	Vetë vlerësim	Performancë e përgjithshme
ÇELËS për tekstin që mund të shihni në kuti mbi raportin e fëmijës suaj:								
Earth and Space Science [Shkenca e tokës dhe hapësirës]				Physical Sciences [Shkencat fizike]				
Life Science [Shkenca e jetës]								
Biology [Biologji]								
Chemistry [Kimi]								

Portofoli i fëmijës suaj është vlerësuar në fushat vlerësuese të mëposhtme:

Niveli i kompleksitetit — Si i ka adresuar fëmija juaj standardet mësimore në secilën lëndë (fushë)

- Studenti adreson një shumëllojshmëri standardesh mësimore (tre ose më shumë) në pritshmëritë e nivelit të klasës në këtë fushë.
- Studenti adreson një mostër të ngushtë të standardeve mësimore të kuadrin të planit mësimor (një ose dy) në pritshmëritë e nivelit të klasës në këtë fushë.
- Studenti adreson standardet mësimore të kuadrin të planit mësimor të cilat janë modifikuar nën pritshmëritë e nivelit të klasës në këtë fushë.
- Studenti adreson kryesisht "aftësitë e qasjes" sociale, motorike dhe të komunikimit gjatë mësimin në bazë të standardeve mësimore të kuadrin të planit mësimor në këtë fushë.
- Fusha reflekton pak ose aspak bazë, ose nuk përputhet me standardin(et) mësimor të planit mësimor që kërkohet për vlerësimin.

Shfaqja e aftësive dhe koncepteve — Përgjigja e përgjigjeve të sakta

- Performanca e studentit është e saktë dhe është me cilësi të lartë në këtë fushë (76–100% i saktë).
- Performanca e studentit është më së shumti e saktë dhe shfaq njëfarë kuptueshmëri në këtë fushë (51–75% e saktë).
- Performanca e studentit është e kufizuar dhe jo e qëndrueshme për sa i përket saktësisë dhe studentit shfaq kuptueshmëri të kufizuar në këtë fushë (26–50% i saktë).
- Performanca e studentit është kryesisht e pasaktë dhe shfaqkuptueshmëri minimale në këtë fushë (0–25% i saktë).
- Fusha nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar një rezultat.

Pavarësi — Sasia e ndihmës që fëmija juaj ka marrë

- Studenti ka nevojë për ndihmë minimale verbale, vizuale dhe fizike për të shfaqur aftësitë dhe konceptet në këtë fushë (76–100% i pavarur).
- Studenti ka nevojë për njëfarë ndihme verbale, vizuale dhe fizike për të shfaqur aftësitë dhe konceptet në këtë fushë (51–75% i pavarur).
- Studenti ka nevojë për ndihmë të shpeshtë verbale, vizuale dhe fizike për të shfaqur aftësitë dhe konceptet në këtë fushë (26–50% i pavarur).
- Studenti ka nevojë për shumë ndihmë verbale, vizuale dhe fizike për të shfaqur aftësitë dhe konceptet në këtë fushë (0–25% i pavarur).
- Fusha nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar një rezultat.

Vetëvlerësim — Ndërgjegjësimi i fëmijës suaj për sa i përket performancës së tij ose të saj

- Studenti planifikon, vetëkorrigjon, monitoron, vendos synime dhe reflekton shpesh në këtë lëndë; janë gjetur disa shembuj të vetëvlerësimit në këtë fushë.
- Studenti planifikon, vetëkorrigjon, monitoron, vendos synime dhe reflekton jo shpesh në këtë lëndë; është gjetur vetëm një shembull i vetëvlerësimit në këtë fushë.
- Nuk janë gjetur prova të planifikimit, vetëkorrigjimit, monitorimit të detyrave, vendosjes së synimeve dhe reflektimit në portofolin e studentit në këtë fushë.

Performancë e përgjithshme — Numri i qasjeve të përdorura nga fëmija juaj për të shfaqur njohuritë dhe aftësitë

- Studenti shfaq njohuri dhe aftësi në disa kontekste, ose përdor disa qasje dhe/ose metoda reagimi dhe pjesëmarrjeje në këtë fushë.
- Studenti shfaq njohuri dhe aftësi në një kontekst, ose përdor një qasje dhe/ose metodë reagimi dhe pjesëmarrjeje në këtë fushë.

Niveli i arritjeve të fëmijës suaj (✓)

Artet e gjuhës angleze	Matematikë	Shkencë dhe teknologji/inxhinieri
ÇELËS i tekstit që mund të shihni në raportin e fëmijës suaj:		
NOT ASSESSED FOR A STUDENT IN THIS GRADE [NUK ËSHTË VLERËSUAR PËR NJË STUDENT NË KËTË KLASË]		
REQUIRED BUT NOT SUBMITTED [E NEVOJSHME POR NUK ËSHTË PARAQITUR]		
STUDENT TOOK STANDARD TEST [STUDENTI KA KRYER TESTIN STANDARD]		
ABSENT [MUNGON]		